388
30.03.2021

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr 1500/1 Prot

Elbasan më 30 /03/2021

# VENDIM

Nr 30 datë 30 /03/2021.

**Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë pë muajin SHKURT 2021**

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" , V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesëmbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 3 datë 27.01.2021 "Mbi miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë"

**VENDOSI**

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i të ardhurave të bashkisë për muajin SHKURT 104 familje me fond 322.080 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Kujdesit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Sekretari i Këshillit Bashkiak**
**Klajd Gripshi**

**Kryetari i Këshillit Bashkiak**
**Hektor Çiftja**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr 1501/1 Prot Elbasan më 30 /03/ 2021

**VENDIM**
Nr. 31 datë 30 /03/2021

**Mbi dhënien e ndihmës ekonomike dhe pageses dyfishe nga fondi i kushtëzuar për muajin SHKURT 2021**

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" , V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesëmbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 4 datë 27.01.2021 "Mbi miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike"

**V E N D O S I**

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike dhe pagese dyfishe nga fondet e kushtëzuara per muajin **SHKURT 2021** gjithsej 146 familje me një fond prej 878.264 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Sekretari i Këshillit Bashkiak**
**Klajd Gripshi**

**Kryetari i Këshillit Bashkiak**
**Hektor Ciftja**

4990
30.03.2021

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1502/1 Prot. Datë 30 .03. 2021

VENDIM

NR. 32 DATË 30 . 03. 2021

MBI

**"Detajim i shtesës së fondeve grant, për pagat në arsimin parashkollor"**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ___.03.2021, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Bashkia Elbasan mbi "Detajim i shtesës së fondeve, për financimin e rritjes së pagave në arsimin parashkollor", bazuar në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqiperisë", i ndryshuar, ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", udhëzimin plotësues nr.4, date 25.01.2021 të Ministrisë së Financave "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021",

VENDOSI

1. Detajimin e shtesës së fondeve (transfertë sektoriale), për financimin e rritjes së pagave në arsimin parashkollor, për vitin 2021, si më poshtë :

| | Njësia shpenzuese | Shtesë fondi | art.600 (paga) | art.601(sig.) |
|---|---|---|---|---|
| -Arsimi parashkollor | Q.Ek.Arsimit | 19,748,402 | 16,948,402 | 2,800,000 |

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Buxhetit dhe Qendra Ekonomike Arsimit.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

**SEKRETAR**
**Klajd Gripshi**

**KRYETARI**
**Hektor Çiftja**

401
30.3.2021

3

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA ELBASAN**
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 1503/2 Prot. Datë 30 .03. 2021

**VENDIM**

**NR. 33 DATË 30 . 03. 2021**

**MBI**

**"Transferim fonde për investime, nga të ardhurat",**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ___ .03. 2021, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Bashkia Elbasan mbi "Transferim fonde për investime, nga të ardhurat", bazuar në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqiperisë", i ndryshuar, ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", udhëzimin nr.4, datë 25.01.2021 të Ministrisë së Financave "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021" dhe vendimin e Këshillit Bashkiak nr.168, datë 24.12.2020 mbi "Miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan për vitin 2021", i ndryshuar,

**VENDOSI :**

1. Transferimin e fondeve per investime në buxhetin e vitit 2021, nga të ardhurat, si më poshtë :

   **Paksohet :**
   - 3,369 mijë lekë, "Ndërtim kënde sportive në lagjen "Skenderbej", artikulli 231, Bashkia

   **Shtohet :**
   - 3,369 mijë lekë, "Studime projektime" (shtese fondi), artikulli 230, ASHP.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria e Prokurimeve dhe ASHP.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

**SEKRETAR**
**Klajd Gripshi**

**KRYETAR**
**Hektor Ciftja**

Adresa: Bashkia Elbasan, Rr "Qemal Stafa",Tel. +355 54 400152,E-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web: www.elbasani.gov.al

402
30.3.2021

5

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

Nr./1504/Prot
//

Elbasan, më 30 03. 2021

VENDIM

NR.34 DATË 30.03.2021

PËR

**MIRATIM DHËNIE BURSE SHTETI NXËNËSIT TË SHKOLLËS SË MESME PROFESIONALE "ALI MYFTIU" PËR VITIN SHKOLLOR 2020 - 2021**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____.____2021 pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Drejtoria e Politikave të Arsimit dhe Edukimit " Mbi dhënien e bursës së shtetit nxënësve të shkollave të mesme të arsimit parauniversitar dhe profesional për vitin shkollor 2020-2021", bazuar në ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetqeverisjen Vendore", Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.666 datë 10.10.2019 "Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet e arsimit publik", për vitin shkollor 2020-2021", me propozim të komisionit të dhënies së bursave të ngritur me urdhër të brendshëm nr.981 datë 14.12.2020 nga kryetari i bashkisë.

**VENDOSI**

1. Të miratojë dhënien e bursës nxënësit të shkollës së mesme të arsimit profesional për vitin shkollor 2020-2021 sipas tabelës bashkëngjitur vendimit.
2. Për zbatimin e këtij vendimi për shkollat e mesme ngarkohet Drejtoria e Politikave të Arsimit dhe Edukimit dhe Qendra Ekonomike Arsimit, bashkia Elbasan.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**Sekretari i Këshillit Bashkiak**
**Klajd Gripshi**

**Kryetari i Këshillit Bashkiak**
**Hektor Çiftja**

403
30.03.2021

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1564/2 Prot. Datë 30 .03. 2021

**VENDIM**

**NR. 35 DATË 30 . 03. 2021**

**MBI**

**"Transferim fonde për investime, nga të ardhurat",**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 30.03. 2021, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Bashkia Elbasan mbi "Transferim fonde për investime, për Klubin Shumësporte", bazuar në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqiperisë", i ndryshuar, ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", udhëzimin nr.4, datë 25.01.2021 të Ministrisë së Financave "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021" dhe vendimin e Këshillit Bashkiak nr.168, datë 24.12.2020 mbi "Miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan për vitin 2021", i ndryshuar,

**VENDOSI :**

1. Transferimin e fondeve per investime në buxhetin e vitit 2021, nga të ardhurat, si më poshtë :

   **Paksohet :**
   - 200 mijë lekë, "Ndërtim kënde sportive në lagjen "Skenderbej", artikulli 231, Bashkia

   **Shtohet :**
   - 200 mijë lekë, "Blerje tabela 24-sekondësh për basketboll", artikulli 231, Kl.Shumësporte.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria e Prokurimeve dhe Klubi Shumësporte.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

**SEKRETAR**
**Klajd Gripshi**

**KRYETAR**
**Hektor Ciftja**

Adresa: Bashkia Elbasan, Rr "Qemal Stafa",Tel. +355 54 400152,E-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web: www.elbasani.gov.al

475
02.04.2021

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA ELBASAN**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**Nr.1035/2 Prot.** **Elbasan më 30.3.2021**

**VENDIM**

**Nr.36 datë 30.3.2021**

***"Për dhënien e titullit "Qytetar Nderi" i Elbasanit,***

***zotit Robert Ndrenika"***

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ___.3.2021, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Arsimit Parashkollor, Trashëgimisë Kulturore, Turizmit dhe Sportit (Sektori i Turizmit dhe i Trashëgimisë Kulturore) *"Për dhënien e titullit "Qytetar Nderi" i Elbasanit, zotit Robert Ndrenika",* mbështetur në nenin 54 (gërma "m") të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar), si dhe në nenin 15 (pika 1, gërma "a" dhe pika 2, gërma "b") të ligjit nr.112/2013 "Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar);

**VENDOSI:**

1. T'i japë titullin "Qytetar Nderi" i Elbasanit, zotit Robert Ndrenika, me motivacionin:

   **"Për kontributin e shquar në promovimin e artit dhe kulturës në teatrin "Skampa" Elbasan, në periudhën 1964 - 1970, ku debutoi dhe punoi si aktor në interpretime me nivel të lartë artistik të pjesëve teatrale".**

2 Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administrata dhe Kryetari i Bashkisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETARI** **KRYETARI**

**Klajd Gripshi** **Hektor Çiftja**

*D. Kristo*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1585 Prot. Elbasan më, 30 .03.2021

**VENDIM**

**Nr. 37 datë 30.03.2021**

***"Për dhënien e titullit "Qytetar Nderi" i Elbasanit (pas vdekjes),***

***zotit Thanas Rula"***

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ___.03.2021, pasi shqyrtoi propozimin e Kryetarit te Bashkise "*Për dhënien e titullit "Qytetar Nderi" i Elbasanit (pas vdekjes), zotit Thanas Rula"si dhe relacionin e Komisionit të Vlerësimit të Figurave,* mbështetur në nenin 54 (gërma "m") të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar), si dhe në nenin 15 (pika 1, gërma "a" dhe pika 2, gërma "b") të ligjit nr.112/2013 "Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar);

**VENDOSI:**

1. T'i japë titullin "Qytetar Nderi" i Elbasanit (pas vdekjes), zotit Thanas Rula, me motivacionin:

   **"Për kontributin e dhënë në zhvillimin ekonomik të qytetit dhe më gjerë.**

2 Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administrata dhe Kryetari i Bashkisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETARI**

**Klajd Gripshi**

**KRYETARI**

**Hektor Çiftja**